



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA



### KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

**Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e nëntë - IX, e rregullt e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 25.07.2019, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.**

**Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës:** Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Betim Ahmeti, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Aida Alimi, Arjana Zogiani, Naser Graçevci, Migjen Kolshi, Shaban Ademi, Mehdi Lahu, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Hysni Hasani, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

**Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtive të Komunës:** Fadil Krasniqi - Nënkyrytar i Komunës, Nuriye Fazliu - Drejtoresh e Administratës, Maliq Berisha - Drejtore i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit dhe Ekrem Berjani - Drejtore i Zhvillimit Ekonomik.

**Të tjerë:** Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban dhe Hysen Sllamniku - Zyrtar për Mirëqenie Sociale.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi përmes mbledhjes dhe prezantoi këtë:

#### REND DITE

1. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim përmes shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore në Fushë-Kosovë.
4. Propozim përmes ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 55, të datës 09.06.2011.
5. Propozim përmes lejimin e mjeteve financiare përmes shërimit përmes Avni Ademi.
6. Propozim përmes rishqyrtimin e aktit sipas shkresës Nr. 0204-940/8, të datës 11.07.2019.
7. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të 'Kompleksit 300' në Fushë-Kosovë, lidhur me ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare.
8. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës shpreh ngushllime familjes Veseli përmes tragjedin e ndodhur. Më pas konstatoi se ekziston kuorumi i mbledhjes, po ashtu e kemi edhe një pikë shtesë të rendit të ditës: Shqyrtimin e kërkesës së banorëve të 'Kompleksit 300' në Fushë-Kosovë, lidhur me ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim përmes aprovimit të rendit të ditës, me pikën shtesë: Shqyrtimin e kërkesës së banorëve të 'Kompleksit 300' në Fushë-Kosovë, lidhur me ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota ‘për’, një ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi I Komunës, me shumicë të votave e aprovoi rendin e ditës së propozuar me pikën shtesë: Shqyrtimin e kërkësës së banorëve të ‘Kompleksit 300’ në Fushë-Kosovë, lidhur me ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare.

### **Pika e parë (1) - Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për betim anëtarin e ri të Kuvendit pas kalimit në pozitën e Nënkyrytarit të Komunës të z. Qerim Gara, kryerjes së procedurave nga Komisioni Qendor i Zgjedhjeve, janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e betimit të anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës z. Hysni Hasani nga radhët e Partisë Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës. Për këtë punë duhet ta formoi edhe një Komision prej tre anëtarëve për verifikimin e mandateve para realizimit të procedurës së betimit sipas nenit 35.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Pas diskutimeve, për anëtarë të Komisionit për verifikimin e mandateve u propozuan: Remzi Shala, Doruntina Jashari dhe Aida Alimi.

Komisioni u votua njëzëri nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, shqyrtoi dokumentacionin në fjalë dhe dha këtë konstatim:

**Remzi Shala:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Komisionit për verifikimin e mandateve, konstatoi se personi i zgjedhur nga lista zgjedhore e Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës z. Hysni Hasani, i plotëson kushtet e parapara me ligj për leximin dhe nënshkrimin e deklaratës solemne të betimit, si anëtar i ri i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Ftoi z. Hysni Hasani përfaqësues i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, pas konstatimit të anëtarëve të Komisionit që ta lexon dhe nënshkruan deklaratën e betimit solemn.

**Hysni Hasani:** Unë Hysni Hasani, betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegjje dhe sipas ligjit detyrat, do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës i urojmë punë të mbarë dhe suksese në punë.

### **Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi pikën, ‘Pjetje dhe përgjigje parlamentare’, ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që ta ngritin ndonjë pyetje për Ekzekutivin e Komunës.

**Durim Hajra:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Anëtarit të ri, i urojmë punë të mbarë. Ngushllime familjes Veseli për tragjedin e ndodhur. Unë kam dy pyetje për Drejtoren e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit?. Pyetje e parë furnizimi me ujë të pishëm, shumica e lagjeve në Fushë-Kosovë, tani furnizohen 24 orë me ujë të pishëm, mirëpo ka disa pjesë të lagjeve të qytetit, të cilat

ujin nuk mund ta shfrytëzojnë për pije, siç janë rrugët në pjesën prej hekurudhës e deri te rrithi, Rruga ‘Vëllezërit Gërvalla’, ‘Drenica’, ‘Fehmi Lladrovci’, ‘Fahri Fazliu’, shumica e asaj pjese nuk mund që ta shfrytzojnë ujin për pije, arsyesa e banorëve është se rrjeti është nga gypat e azbestit që janë gypa kancerogjen, janë gypa të vjetër të cilët janë përdorur në vitet 1930, pyetja ime është se kur do të bëhet ndërrimi i këtyre gypave pasi siç dihet është kompetencë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, që ta përmirësojnë rrjetin e ujësjellësit. Pyetja tjeter, është lidhur me problemin me ndriçimin publik dhe problemin me trotuare dhe kanalizime?. Në rrugën ‘17 shkurti’, në lagjen ‘Dardadnia’, ka një kohë të gjatë që kjo pjesë ka problem me ndriçimin publik dhe kanalizim. Po ashtu, një pyetje tjeter e kamë edhe për Drejtoren e Planifikimit Urban?. Ne shpesh herë jemi ankuar tek cilësia e dobët dhe puna shkel e shko e kompanive, për rrugën ‘Hajrullah Zymi’, jemi dëshmitar të gjithë se me 3 korrik është rindërtuar, mirëpo vetëm pas tri javë ka filluar të prishet. A po mbikëqyrë këto punime dhe puna e kompanive të kontraktuara?. Puna nuk është duke punur siç duhet, fillimisht është dashur baza të irregullohet duhet të ketë bazë të fortë, po ashtu ka ankesa nga qytetarët se nuk e ka cilësinë e duhur.

**Eglantina Azemi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Anëtarit të ri i urojmë punë të mbarë. Ngushllime familjes Veseli për tragjedin e ndodhur. Unë kam një pyetje, për Drejtoren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale?. Qytetarët na kanë raportuar se në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë, duhet të presin deri me dy orë radhazi për marrjen e një infuzioni, ngase nuk ka shtretër të mjaftueshëm për të marrë këtë shërbim shëndetësorë, sa do që të jetë gjendja e rëndë e tyre. Vlenë të theksohet se janë vetëm katër shtretër edhe ata në gjendje, jo të mirë. Po ashtu, në qoftë se ndodh që mjeku ta përshkrujë reçetën një orë pasi të përfundoi ndërrimi, atëherë pacientët duhet të presin një orë deri në ndërrimin tjeter për ta marrë infuzionin, ata kanë dërguar edhe fotografi ku recepcioni ka qenë i zbrazur tek sa radha e pacientëve është shtuar. Ne e kuptojmë që doktorët dhe infermerët kanë nevojë për pushim, por është mirë që pushimet të kordinohen mes veti dhe të mos mbetet ambulanta pa mjekë dhe infermere, andaj ju pyes, se si duhet të zgjidhet ky problem?.

**Bashkim Krasniqi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Faleminderit për ngushllimet. Unë si përfaqësues dhe si asambleist kamë pritur më shumë edhe prej Kuvendit të Komunës, por edhe prej Kryesueses, Nënkyetarit dhe asambleistëve, që çdo njëri prej tyre do të më telefonoi dhe të paktën, të më pyesin, se si ka ndodhur rasti, mirëpo një gjë të tillë s'kam marrë nga asnjëri. Një pjesë e asambleistëve këtu, në kohën e zgjedhjeve vjen dhe kërkon vota tek ata banorë dhe merr vota nga ata banorë të asaj lagje, zgjidhet asambleist dhe i bjen barra barabartë me mua edhe pse unë jam përfaqësues, duhet te pakten ta ketë interesim. Personi që ka kryer këtë vepër është në polici, i ndjeri ka qenë i përdhunuar seksualisht dy herë dhe herën e tretë vdes në vendin e ngjarjes ky fëmijë, i cili është i moshës nëntë vjeçare. Ne kemi dyshuar në procesin dhe intervenimin e policisë. Rasti është lajmëruar dy herë, babai i të dyshuarit e ka lajmëruar rastin në polici dhe kemi dyshuar se policia nuk e kanë kryer punën si duhet, deri sa kemi mbajtë edhe protestë. Falënderoi z. Durimin i cili ishte i vetmi pjesëmarrës nga asambleistët në protestë dhe më ka përkrah, edhe pse në atë protestë është dashur të jetë edhe dikush tjeter prej asambleistëve. Barra kryesore për këtë rast i jetë prokurorit, se nuk e ka përfunduar punën e tij, siç duhet dhe mendoj, se prokurori e

ka vendin barabartë me të dyshuarin ne burg. Familja jeton në gjendje tepër të rëndë ekonomike, familja nuk ka as tokë, as shtëpi, unë kam arritur përmes një Organizate, me ja siguruar shtëpinë në momentin që ne t'i sigurojmë tokën, mirëpo tokën ne nuk kemi mundur të sigurojmë ende, ne i kemi mbledhur 3,500.00€, falë edhe ndihmës së bashkëatdhetarëve tanë të cilët jetojnë jashtë vendit, të cilët kanë shprehur interesimin për t'i ndihmuar kësaj familje, me këtë rastë kaq të ndishëm. Mirëpo toka po kushton afër 7,00000€ - 8,000.00€, dy ari tokë. Përndryshe, familja duhet të dërgohet në fshatin Plemetin të Obiliqit, unë nuk e di se si, do të mbesim ne si komunë që për 4,000.00€, të shkojë kjo familje dhe të jetojë në fshatin Plemetin të Komunës së Obiliqit. Për këtë rastë kaq të ndishëm që ka ndodhur, pres bashkarisht ta bëjmë një zgjidhje për këtë familje, sepse unë vetë nuk mundem t'i ndihmoj askujt.

**Remzi Shala:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ju shpreh ngushllime familjes Veseli, jemi të shqetësuar të gjithë për rastin që ka ndodhur. Kemi besim tek organet e drejtësisë pa marr parasysh, se për kënd bëhet fjalë, ata që e kanë shkel ligjin të dënohen, ky rast është për keqardhje. Personi në fjalë është banorë nga Fushë-Kosova, banori i të gjithëve, andaj edhe një herë ngushllime familjes. Sa i përket pyetjes së kolegës se në institucionin ku unë punoj dhënia e infuzioneve në bazë të statistikave në bazë të raportit vjetor, është një prej qendrave që ipen më së shumti infuzione, është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë. Dhënia e infuzioneve është për raste emërgjente. Hapësira është e vërtetë që është e vogël, prandaj infuzionet nuk mirren askund më shumë se në Qendrën tone shëndetësore, duhet të jeni të bindur për këtë. Pauza duhet të respektohet, sepse është e garantuar me ligj. Nëse ka keqpërdorime është mirë të raportohen, me emër dhe mbiemër, sepse jo gjithëherë personeli kujdestar për rastë emërgjente jepin përgjigje.

**Migjen Kolshi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Urime për anëtarin e ri të Kuvendit të Komunës, i dëshirojmë punë të mabrë dhe suksese. Për rastin në fjalë që u përmend nga Bashkim të gjithë jemi të shqetësuar që ka ndodhur, ndoshta nuk më ke parë, por edhe unë kam qenë i pranishëm në protestë. Por si do qoftë ju na kritikuat dhe unë dua të foli pak për atë rast sikur ju dhe shumë kolegë tjerë të komiteteve të ishit marrë pak, më shumë me ato raste nuk do të kishte ardhur puna deri këtu. Unë jam anëtar i Komitetit për Komunitete, më shumë foli unë dhe Durimi në Komitetin për Komunitete se sa përfaqësuesit e juaj aty. Ky rast na ka prekur të gjithëve, por është mirë që ju si pjesëtar dhe kolega i ri tash që ka ardhur në Kuvendin e Komunës, të mirreni më shumë me qytetarë dhe mos t'i kqyrni vetëm interesat e juaja, sepse ata që kan qen më herët vetëm interesat e tyre i kanë shiquar. Ne nuk kemi njojuri shumë për atë pjesë andej, meqenëse ju jeni pjesëtarë i asaj zone, ndërsa sa i përket kërkesës është mirë që Drejtori i Financave dhe Buxhetit, të marr parasysh këtë rast dhe besoj se edhe nga ne kolegët, do ta keni përkrahjen. Komuna duhet t'i dal në ndihmë kësaj familje, me aq sa ka mundësi.

**Doruntina Jashari:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë po mendoj, se meqë rasti ka ndodhur nuk është koha për akuza se çka kemi bërë deri më sot, por mos t'i përsërisim më gabimet që kanë ndodhur deri më tani. Tash e tutje të bëjmë më shumë, jo vetëm për këtë komunitet por për të gjithë qytetarët e Fushë-Kosovës, duke ju afruar fillimisht siguri. Ne e përkrahmi çfarë do formë për t'i ndihmuar kësaj familjeje.

**Durim Hajra:** Mirëkuptim për Bashkimin, se nuk kemi bërë as ne si asambleistë, si Kuvend, asnjë reagim, mirëpo pa faj nuk jemi, as ne Kuvendi i Komunës, me një shprehje ngushllimi të paktën nëpër media. Në titor të vitit të kaluar, kemi pas një projekt: si të trajtohen fëmijët në situata rruge? Siç është tani edhe rasti i të miturit nëntë vjeçarë. Ka qenë një Organizatë Zvicerane, e cila ka ardhur me një projekt konkret, se si të trajtohen këta fëmijë në situatë rruge, një prej arsyeve kryesore ka qenë se këta fëmijë, po abuzohen, po keqtrajtohen. Ne si Kuvend, kemi patur përparrë një zgjidhje për këtë kategori të njerëzve, që kanë qenë fëmijë, një kategori kaq e ndishme, mirëpo e kemi refuzuar dhe atë objekt, që e kanë kërkuar, ky Kuvend më shumicë të votave e votuar për arkivën e komunës. Të kemi kujdes në të ardhmen, kur vinë projekte të tillë mos t'i refuzojmë, sepse ata kanë kërkuar një objekt, që i ka përbushur kërkeshat e tyre, kjo ngjarje tragjike të jetë mësim për herave tjera, sepse këta fëmijë po keqtrajtohen, duhet të marrim masa që të mos ketë më pasoja.

**Nënkyetari i Komunës:** Përshëndetje për të gjithë. Asnjëherë nuk duhet të mirremi me rastin pasi që ai ka ndodhur. Më vjen keq që ka ndodhur, në as një projekt që ka ardhur nga Organizatat tjera në Komunën e Fushë-Kosovës deri tani nuk ka ndodhë, që komuna s'ka qenë pjesëmarrës në financimin dhe ndërtimin e atyre shtëpive. Bashkimi është desht me mendu dhe me fut në listë për shtëpi, persona që e kanë gjendjen e vështirë, para se të ndodh rasti, për ata egziston komuniteti për ata është edhe Nënkyetari i Komunës për Komunitete, më vjen keq për këtë rast që ka ndodhur, ju e dini që kësi raste ndodhin edhe te komunitetet tjera, jo vetëm te komuniteti juaj, që është për keqardhje. Realisht duhet ta gjejmë momentin që t'i ndihmojmë, mirëpo komuniteti asnjëherë nuk ka patur pengesa që t'i ndihmon familjeve të tjera. Ne tokë s'mundemi me i blerë askujt për arsy, se nëse veç komuna fillon me hy me blerë tokë për qytetarët, atëherë ne jemi në bllokim nga kërkeshat e qytetarëve, nuk e kemi këtë të drejtë. Nëse ka mundësi, komuniteti mundet me i ndihmu asaj familjeje, janë edhe forma tjera vullnetare, që i ndihmojnë dhe ndjejnë dhimbje për këtë familje. Gjithmonë kemi qenë të gatshëm me ju ndihmur, jemi me ju ndihmu aq sa kemi mundësi. Por njerëzit jetojnë ku dojnë vetë ne s'mundemi me i pengu askend. Mirëpo ju z. Bashkim kishte qenë mirë të punoni më shumë dhe mos të lejoni që ajo familje të shkon në Obiliq. Të tregon që është një Zëvendësministër, një këshilltar komunal, një punëtor i vyeshëm.

**Bashkim Krasniqi:** Faleminderit për sqarimin z. Nënkyetar. Unë nuk e akuzova askënd dhe nuk e kam ndërmend me akuzuar. Vetëm dje janë përvuar 16 shtëpi të reja në bashkëpunim me shoqatën nga Katari, iniciator jam unë e falenderoj komunën, se edhe komuna e ka dhënë një pjesë të buxhetit për ato familje. Unë kërkova vetëm tokën me siguruar, sepse shtëpinë do ta ndërtojmë menjëherë. Familja nuk e ka tokën sepse po ta kishte tokën shtëpinë do ta ndërtojmë menjëherë. E mbështes fjalimin e z. Durimit plotësisht si qytetarë të Fushë-Kosovës me marrë për obligim me i ndihmuar, nëse është i nevojshme, e sa i përket Komunës së Fushë-Kosovës është e vërtetë se na keni ndihmuar çdoherë.

**Driton Ademi:** Përshëndetje për të gjithë. Projektin për trajtimin e fëmive në situate rruge, e keni tërhek duke e zëvendësuar me arkivën dhe përfundimisht me arrogancë në asamble, është vendos kështu, andaj përgjegjësia nuk është kolektivisht, është mirë me i marrë dhe me i shikur procesverbalet, se si është votuar, është mirë me i publiku. Mendimi im është që të përkrahen këto

projekte, është mirë me i ndarë secili përgjegjësitë. Na vjen shumë keq për rastin e ndodhur. Nëse ne nuk veprojmë situata vjen duke u keqësuar.

**Aida Alimi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës i urojmë punë të mbarë dhe suksese në punë. Ngushllime familjes Veseli. Shpresjomë që këto raste mos të përsëriten më. Kam shumë pyetje, mirëpo më duhet ta liroj sallën për arsyen personale. Plotësimi i vendimit Nr. 55, të datës 09.06.2011, për shkak të ndërtimeve të bëhen disa ndryshime, deshta me shtu se këto ndryshime janë të mirëseardhura, por të jenë në kohen e duhur është dashur të ndodh shumë më herët. Po ashtu, kam edhe një pyetje për Drejtorin e Planifikimit Urban te ‘Kompleksi i Apollonisë’, çdo mbrëmje lëvizin kontejnerat prej një pjese, në pjesën tjetër, unë kisha propozuar, se para se te ipet leja, të shikohet mirë se ku mund të vendosen kontejnerët.

**Driton Hasoli:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit. Rruga ‘Marin Barleti’ në fshatin Bardh i Madh, ende nuk është rregulluar, është në gjendje gati të pakalushme, kur do të intervenohet për rregullimin, kjo pjesë e rrugës është e gjatë gati 30 metra?. Kjo rrugë është në dalje të fshatit Kuzmin deri te ura mbi Sitnicë, është me gropë dhe e pakalueshme dhe ka dëme në makina. Pyetja ime është kur do të rregullohet kjo pjesë e rrugës?

**Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis:** Përshëndetje për të gjithë. Unë ju falënderojë për pyetjet e sinqerta z. Durimin dhe të gjith juve tjerëve. Në momentin e kyqjes se gypit të ri të Fushë-Kosovës në fabriken e re të Shkabajt, janë ngritur shqetësime tjera për lagjen e Nakaradës dhe lagje tjera, kjo na ka bërë që të kem kontakte të përhershme të themi çdo javë me menagjerin dhe Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit. Në javën e kaluar ka qenë në takim, Nënkryetari me Drejtorin dhe Kryeshefin Ekzekutiv, është biseduar edhe ajo që ju e thatë ndërrimi i gypave për shkakë të vjetërsisë së tyre dhe është bisedur që në planin e buxhetit të Kompanisë të hyn edhe fshati Bardh i Madh me rrjetin e ri, së bashku me fshatrat Kuzmin, Pomozotin dhe Bardh i Vogël. Sa i përket ndriçimit publik, ne kemi ardhur deri te shkëputja e kontratës me Kompaninë që e kemi pasur dhe e kemi kontraktuar një Kompani të re, besojmë se pas një javë do të filloj punën dhe rregullimin e të gjitha fshatrave dhe sanimin e problemeve të paraqitura. Tek mbushja e gropave ne kemi kontraktuar edhe këtë një Kompani, e cila ka fillur mbushjen e gropave në qytet dhe ka arritur deri tek Kuzmini, do të vazhdoj deri në Bardh të Madh, pastaj në rrugën e ‘Dardanisë’, rrugën ‘Nënë Tereza’ sepse kemi kontratë tri vjeçare.

**Ali Ismaili:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Urime për anëtarin e ri të Kuvendit të Komunës. Ngushllime familjes Veseli. Rruga kryesore në fshatin Lismir deri tek shkolla është bërë si breg, meqë andej kanë kaluar kamionat me tonazh të madhe.

**Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis:** Faleminderit për pyetjet. Aida qe tri vjet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, lëshon leje mjedisore për ndërtim të objekteve dhe as një leje nuk e kemi lëshuar deri me tanin pa u caktuar, vendi i mbeturinave kjo është e rregulluar me ligj.

**Bashkim Krasniqi:** Unë si asambleistë e kam fituar një projekt me ndërtimin e katërdhjetë shtëpive, nëse komuna na siguron pronën. Në atë lagje do të ketë një ambulant dhe një shkollë. Nëse ka komuna tokë atëherë ne mund të fillojmë prosedurën, është projekt i përbashkët për ata që nuk kanë shtëpi, një projekt madhështor për ndërtimin e katërdhjetë shtëpive.

**Nënkyetari i Komunës:** Asfalti që është dëmtuar në rrugën ‘Hajrullah Zymi’ duhet të shikohet sepse ajo Kompani e merr një garacion në komunë dhe nuk duhet të lëshohet garacioni, nëse nuk e ka përfunduar punën si duhet. Kompanitë duhet të garantojnë për punën e përfunduar. Jemi në kontakt të vazhdueshëm sa i përket ujit, ndërsa sa i përket shëndetësisë është e vërtetë, sepse ka shumë patientë, për ata ne po dojmë ta ndërtojmë edhe një Qendër të Mjekësisë Familjare, që të ketë më shumë hapësira.

**Pika e tretë (3) - Propozim për shëndrrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore në Fushë Kosovë.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi pikën ‘Propozim për shëndrrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore në Fushë Kosovë’. Ftoi, znj. Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

**Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban:** Përshëndetje për të gjithë. Në mungesë të Drejtorisë të Planifikimit Urban, unë jam e ftuar t'i arsyetoj pikat e rendit të ditës që vijnë nga Drejtoria e Planifikimit Urban. Propozimi për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore ka të bëjë me investorin sh.p.k-në ‘Korali’, sipas ligjit, shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore të klasës pesëtë kërkohet të bëhet nga Kuvendi i Komunës, andaj duhet ta bëjë pëlqimin për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, sipas Planit Zhvillimor Komunal kjo tokë është e vijatuar që të ndërtohet si zonë e biznesit, ku kjo zonë e biznesit përfshinë hapësirën prodhuese, shërbysë dhe tregtare, kjo hyn në hapësirën prodhuese. Pala është pajisur me kushte ndërtimore, të cilat i takojnë sipas Planit Zhvillimor Komunal. Deri në kategorinë e katëert shndërrimin e bënë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ata kanë obligim që ta formojnë një Komision i cili del në terren, e verifikon e pëlqimin në urbanizëm, a është në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal dhe vazhdon procedura e pagesës me tarifa për metër katrorë, pastaj vjen deri tek pajisja me leje ndërtimore, ku kërkohet një konfirmim të cilin e arsyeton Ligji i bujqësisë, nen 6.3 i cili ka të bëjë me shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore për kategorinë e pestë dhe gjashtë, që ka të bëjë me vendimin e Kuvendit të Komunës.

**Driton Ademi:** Unë, nuk di as pse të diskutoi, në Komitetin për Politikë e Financa, është dashur të sqarohet se Udhëzimi Administrativ Nr. 41/2006, është dashtë të shoqërohet me plotësimi ndryshimin me Nr. 10/2010, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e cila mund ta kthen vendimin. Pyetja ime është, a është ndërrim i destinimit këtu i përhershëm apo të përkohshëm?. Ne si parti Nisma Socialdemokrate jemi kundër ndërrimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore.

**Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban:** Sa i përket pyetjes, se a është ndërrim i destinimit i përhershëm apo i përkohshëm, është ndërrim i përhershëm. Objekti i përkohshëm sipas ligjit të ndërtimit është kioska deri në 10 metër katrorë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim ‘Propozimin për shndërrimin e tokës bujqësore, në tokë ndërtimore në Fushë-Kosovë’.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota ‘për’, një ‘kundër’ dhe pesë abstenime, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për shndërrimin e tokës bujqësore, në tokë ndërtimore në Fushë-Kosovë’ dhe mori:

#### V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 248, të datës 19.06.2019, për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për palën Nazif Muharrem Nazifi në Fushë-Kosovë.

#### **Pika e katërt (4) - Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 55, të datës 09.06.2011.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 55, të datës 09.06.2011. Ftoi, znj. Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

**Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban:** Ne si Drejtori e Planifikimit Urban kemi shumë kërkesa të mëdha për ndërtimet e banimit kolektiv, sidomos në zonën prej çerdhës e deri te hekurudha kryesisht. Vendimi Nr. 55, është në kuadër të Planit Zhvillimor Urban ku janë përdorur norma teknike, distanca prej një metër, kur s'kemi hapje të dritareve, në bazë të cilit ne kemi punuar, kemi drejtë të dalim me konzola, banimet individuale, pëlqimin e ndërtimit për banime kolektive dhe bodrume. Këtë vendim e kemi pa të arsyshme ta ndryshojmë pas daljes së Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2017, ku distanca prej një metër dhe për shkak të aprovimit të ligjit, mbrojtja nga zjarri e tjera, shumë pika kanë ndërhyrë njëra me tjetër dhe kemi qit propozim, që pika numër një që ka qenë distanca prej një metër, të zgjerohet me disa pika të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2017, ku tregohen saktë distancat ndërmjet objekteve. Kërkesë e Drejtorisë tonë është që ky vendim të miratohet, sepse kjo punë është e lidhur me vendimin Nr. 81, interpretimin ligor që e ka kërkuar Kryetari i Komunës, nga Përfaqësuesja Juridike e Komunës për punën në lidhje me ndërtimet, meqë në terren 95% e punimeve sipas vendimit Nr. 55 kanë përfunduar, me këtë ndryshim-plotësim të vendimit Nr. 55, koeficienti i ndërtimit arrin deri në 3.2, zbatimi i tij duhet të vlenë deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës, e cila ka ngecur.

**Driton Ademi:** Unë nuk e di, a e dini çka përfshinë ky vendim, është dashur që këtë vendim ne me pas si pjesë të materialit, para se me ardhur këtu në mbledhje, sepse vendimi është i vitit 2011. Distanca ndoshta ndërlidhet me rastet e fundit, ky vendim është krejtësisht i panevojshëm që të përfshinë këto nene, pjesërisht u përfshi, nuk e di a kemi ndonjë arsyeshmeri sepse mungon, te neni 4.2.6, 4.2.7, pika 4.2.4, po ashtu nga pika 4.2 janë marrë vetëm dy rreshtat e parë të këtij nenii dhe nuk janë marrë dy të tjerët, të cilët janë shumë të rëndësishëm, sepse kanë të bëjnë me emërgjencat dhe mbrojtjen nga zjarri, siguirinë posaqërisht me privatësinë. Ne si parti Nisma Socialdemokrate jemi kundër këtij vendimi.

**Durim Hajra:** Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 55, ne se kemi përpala ky vendim i takon të kaluarës, pajtohem plotësisht me parafolsin, se neve sot është dashur ta kemi përpala këtë vendim. Po ashtu edhe nëse mirret vendimi ju nuk i përbaheni. Ndoshta më mirë është ta presim edhe miratimin e Hartës Zonale të Komunës, sepse gjendja në terren, nuk është e mirë, pas arrestimeve të dy zyrtarëve, të cilët janë nën hetim kryesisht për këto vendime.

**Nënkyetari i Komunës:** Dy zyrtarët nuk janë nën hetime, ata janë të liruar dhe nuk është mirë që në një foltore të folësh për gjërat e përfunduara. Nëse e liron gjykata është krejtësisht në rregull.

**Naser Graçevci:** Faleminderit Kryesuese, pëershëndetje për Nënkyetarin, shoqërinë civile dhe media të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës. Urime për kolegut e ri. Ngushllime familjes Veseli për rastin e ndodhur. Vërejtje shumë e madhe për Kryesinë, mënyren se si na i sjell projektet apo një material, një temë të veçantë, këtu 90 % nuk jemi me profesion teknik, nuk jemi arkitektë dhe nuk e dimë saktësisht, çka targeton një pikë e caktuar. Ne nuk jemi me pengu këtu Ekzekutivin e Komunës, por kemi të drejtë për sqarime ose në raste të caktuara të bëhen komisione nga Kuvendi për pika të caktuara, të na jasin sqarime të mjafreshme dhe njohuri më të mëdha.

**Mehdi Lahu:** Përshtendes te pranishmit në mbledhje. Unë pajtohem plotësisht me Dritonin dhe Durimin, se ku vendim është dashur të jetë në material, ta shikojmë se çka ka patur atëherë dhe çka ka tanë dhe ta bëjmë krahasimin. Unë isha ndalur tek pika 12, ku thotë në rast të pamundësive në zonat e veçantë sidomos në zonat e ndërtuara, aty ku nuk mund të bëhet bashkimi i parcelave për formimin e parcelës me sipërfaqe prej minimum 10 ari, të cilat ndërtimë thujse kanë përfunduar, duhet të përcillet vija ndërtimore e bllokut me standartet e mbrojtjes nga zjarri, që parashihet një distancë prej katër metra gjerësi dhe pesë metra lartësi. Vërejtja ime është se meqë nuk e kemi vendimin e vitit 2011, atë distancë që ka qenë atëherë duhet ta dimë. Nëse një objekt nuk i ka plotësur kushtet, ose nuk është bërë pranimi teknik i tij dhe ai objekt tanë egziston t'iu mundësoni hapësirën ma të vogël, që pa i plotësuar disa kriterë tjera të ndërtohet, unë kisha dhënë një propozim për mos me shqyrta, pastaj kur të vimë tek Harta Zonale e Komunës, ta parashohim edhe këtë këndin prej 45 shkallëve, që ju keni punuar dy vite keni paguar edhe kompani për këtë punë. Me këtë pikë unë po mendoj, se po mbyllët lagjia 'Dardania', sepse edhe ashtu është e mbyllur dhe e stërvarkuar, të mos bëhen këto pranime teknike. Po ashtu tek pika 13, te koeficentit i ndërtimit që është 3.2, në Hartën Zonale të Komunës, askund nuk kemi koeficent mbi 3 për ndërtimë të larta, fillon 2.2 e tutje. Në qoftë se na lejojnë të punohet me 3.2, pas dy tre muajve, nëse na vjen Harta Zonale e Komunës aprovojen këto objekte, nuk kanë me përfundur për dy-tre muaj dhe këtu kemi me ba një padrejtësi, pse nuk jeni kordinuar me Harten Zonale të Komunës, që edhe nëse fillojmë me koeficientin 3 me lëshu leje, ne po mundoheni me i shfrytzu edhe këto leje, që s'keni mujt me i marrë, pastaj kur të vjen Harta Zonale, fillojmë me Hartën Zonale, kjo punë kështu nuk është në rregull.

**Ali Ismaili:** E nderuara Kryesuese, të nderuar kolegë, po filloj nga komitetet të cilat i kemi caktuar dhe ma shumë janë për ueb faqe, i kan qit aty tanë egzistojnë se deri tanë s'kanë egzistuar, për pesë vite asnjëherë. Kam propozuar që të gjitha këto komitetet, që janë në bazë të Udhëzimit Administrativ dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, me marrë një vendim nga Kuvendi i Komunës për pagesën e tyre, ashtu si kanë vepruar edhe komunitat tjera. Sa i përket Partisë së Drejtësisë, komitetet nuk janë të ligjshme, mirëpo kjo punë mbetet në përgjegjësinë e atyre që i marrin këto vendime. Nuk pajtohem me Nënkyetarin që thotë se nuk dojna mi lënë në mëshirën e departamenteve atje. Udhëzimi Administrativ ka hyrë në fuqi, ne jemi në vitin 2019, kjo i bjen që prej vitit 2011 deri në vitin 2017, e kemi patur një vendim dhe kemi punuar siç kemi dashtur vetë. E ftoj, ekspertët nga Ekzekutivi i Komunës që të dalin në terren dhe ta shiqojnë në rrugën 'Pajazit

Islami', sepse unë jam shumë afër dhe kojshiu im i cili ka filluar me punu, nuk e ka lejen ndërtimore, por ai po punon. Nëse ju nuk merrni masa atëherë na mbetet neve qytetarëve, që të ankohemi këtu, e në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, sepse kjo punë nuk është në rregull. Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nuk e keni zabatuar për dy vite dhe për ata është krijuar, ky vakum, unë jam me i lënë qytetarët me punu deri sa të na vjen Harta Zonale e Komunës, sepse edhe ato harta me shumë kanë të bëjnë me çështje politike, sesa diçka tjetër. Ju nuk jeni duke i zbatuar rregullat, pyetja ime është se a parashihen këto masa me Udhëzimi Administrativ për ta marr këtë vendim në raport me këto masa?. S'keni patur nevojë fare me sjellë këtë vendim këtu.

**Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban:** Po më vjen shumë mirë kolegë sepse unë jamë për këtë participim përfaqësuse ligjore dhe unë po kerkoj, sqarime nga ministria dhe asnjëherë nuk po kam sqarime për Udhëzimin Administrative kur nuk ka planifikim hapësinor. Distanca me udhëzim administrative ndërmjet blloqeve është një metër. Sipas ligjit për ndërtim neni 18, largësia sipas rrëthinës është pesëdhjetë metra kjo vlenë për nivel vendi, sipas projeksjoneve në Hartën Zonale të Komunëslargësia nga qasja në rrugën kryesore duhet të jetë njëzet e pesë metra. Normat teknike për ndërtim zbatohen sipas udhëzimit dhe vendimit, ne si komunë zyrtarisht i kemi vetëm 34000 banorë, numri i tyre është rritur në bazë të orëve të rrymës dhe njehësorëve të ujit në 38000 banorë dhe nga këto shifra del edhe koeficienti i ndërtimit, sipas hartës zonale në periudhën e ardhshme pas miratimit që arrin maksimum deri në 3, me këtë vendim është 3.2. Në vazhdim sqaroi para anëtarëve të Kuvendit të Komunës normat teknike për ndërtim. Unë jam personi që kam qenë nën hetim dhe jam liruar nga prokuroria. Përveq- vendimit Nr. 55, ne e kemi edhe revidimin e Planit Zhvillimor Urban 2021.

**Ali Ismaili:** Pyes, si veprohet kur janë më pak se dhjetë ari, unë në pronën time i kam tetë ari, a duhet të bashkohet pronat, me pronën fqinje apo si?.

**Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban:** Ndërtimet për prona deri në dhjetë ari janë mbyllur nëpër blloket ekzistuese, në zona të tjera duhet të jenë minimum dhjetë ari për ta marrë lejen e ndërtimit. Në blloqe duhet të respektohet vija ndërtimore.

**Driton Ademi:** Është shumë keq që ju nuk jeni duke sqaruar asgjë në lidhje me vendimin që propozoni të merrët, te pika 4.8 lidhur me gjatësinë e vijës ndërtimore, nuk e keni vazhduar tekstin e plotë, ju po tentoni ta ndreqni gjendjen aktuale, duke shkelur kriteret dhe parametrat për ndërtim që parashihen me ligj dhe udhëzim, e duhet të përfshihen në planin zhvillimor urban.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për ndryshimin-plotësimin e vendimit Nr. 55, të datës 09.06.2011.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', tre 'kundër' dhe tre abstenime, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 55, të datës 09.06.2011' dhe mori:

#### V E N D I M

Për aprovimin e 'Propozimit Nr. 269, të datës 16.07.2019, për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 55, të datës 09.06.2011'.

**Pika e pestë (5) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për shërim për palën Avni Ademi.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për shërim shëndetësorë për palën Avni Ademi. Ftoi, z. Hysen Sllamniku - Zyrtarin për Mirëqenie Sociale që të na jap sqarime.

**Hysen Sllamniku - Zyrtar për Mirëqenie Sociale:** Përvendosje për të gjithë. Në mungesë të Drejtoret të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, unë jam i ftuar të jap sqarime. Pala Avni Ademi, është i lindur me 24.04.1972, mirëpo që nga viti 2016 ka probleme me zemër. Pala ka bërë kérkesë me datën 17.06.2019 dhe pas shqyrtimit të kësaj kérkese në Drejtoren e Shëndetësisë dhe pas konsultimit lidhur me mundësitet buxhetore të Kuvendit të Komunës kryesisht kemi propozuar një ndihmë financiare në shumën prej 5,000.00€, për shërimin shëndetësorë të palës Avni Ademi. Kjo shumë nuk korrespondon me shumën e kérkesës që e ka kérkuar pala, mirëpo mundësitet buxhetore janë tilla, andaj ne propozojmë që palës Avni Ademi t'i ndihmohet në shumën prej 5,000.00€.

**Ali Ismaili:** Të nderuar kolegë, unë çdo herë jam për t'i ndihmuar qytetarët, mirëpo ajo që nuk po më pëlqen, është se personi në fjalë nuk ka marrë intervenimin në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, nuk kemi asnë dokument që personi ka kérkuar ndihmë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Në momentin që i'u është keqësuar gjendja ka kérkuar ndihmë në Spitalin Amerikan, ne këtu kemi vetëm dokumentacione të spitaleve private. Unë mendoj se pala fillimisht është dashur të kérkoj ndihmë së pari, në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë dhe ta marr një përgjigje edhe nga spitali. Ku çdo javë mblidhet Komisioni i përbërë nga pesë anëtarë dhe ky komision merr vendim, se pacienti në fjalë nuk ka shërim në spitalin tonë dhe pastaj në momentin e marries së vendimit i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë, të cilët minden me i ndihmu pacientit për shërim jashtë vendit. Unë nuk e di se pacienti, a ka kérkuar ndihmë në spitalin tonë publik, mirëpoasnë dokument nuk është në dosjen e tij, që ka bërë kontrolla në spital. Ju vendimin prap e merrni si të dëshironi, sepse unë nuk mundem me ju kalu me vota, por të gjithë ne e dimë se në këto klinikat private si po veprohet, kështu po hapim problem tjera nëse ne vepojmë kështu.

**Remzi Shala:** Unë kam diskutuar disa herë në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe në Kuvendin e Komunës, për ofrimin e ndihmave financiare për personat me nevoja të veçantë, është e vërtetë se trajtimi jashtë vendit duhet të shkojë përmes Komisionit të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili e rekomandon pacientin për shërim jashtë vendit. Komuna e Fushë-Kosovës ju ka dalur në ndihmë gjithëherë personave me nevoja të veçanta. Ne i respektojmë rregullat dhe ligjet. Pala Avni Ademi, nuk qëndron mirë financiarisht dhe gjendja shëndetësore e tij është shumë e rëndë. Ka bërë vizita edhe në institucionet publike, unë nuk e di pse nuk i ka sjellur dokumentat. Pala ka nevojë për ndihmë edhe më shumë, mirëpo këto janë mundësitet buxhetore për t'i ndihmuar.

**Driton Ademi:** Unë nuk hy tek procesi i votimit për shkak se kam konflikt interesit, tek personi në fjalë. Ka patur intervenime, edhe në Qendrën Klinike Universitare, është e drejtë e juaja të kérkon që lënda të kompletotohet.

**Migjen Kolshi:** Sa i përket këtij rastit në fjalë, unë afër gjashtë viteve jam këtu në Kuvendin e Komunës dhe ka patur shumë raste, i vetmi rast që ka shkuar përmes komisionit është rasti i

Xhevdet Qiriqi, të cilin komisioni e ka shqyrtuar dhe vlerësuar, se nuk ka shërim këtu dhe duhet të bartet për trajtim jashtë vendit për shërim. Ne së pari duhet t'i shikojmë mundësitë, se a mund të shërohem këtu, apo duhet trajtim jashtë vendit. Po ashtu, në rastet që kemi shqyrtuar me herët kanë kërkuar 6,000.00€ dhe vendimi është merrë për 9,000.00€, e tani kemi të kundërten, pala ka kërkuar 16,000.00€ dhe ju propozoni që t'i lejohen vetëm shuma prej 5,000.00€, kjo punë nuk pom më duket në rregull. Kërkoj nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës që mos të na vinë raste të tillë më në Kuvendin e Komunës, unë propozoi që nëse janë mundësitë të i ndajmë shumën prej 7,000.00€, nëse ka buxhet.

**Ali Ismaili:** Të nderuar, unë jam për gjashtë vite asambleist dhe nuk mundem me pranu, kur ju thoni është rasti i fundit dhe prej tanë do të kemi trajtim ndryshe, kjo nuk ka ndodhë në të kaluarën. Ne duhet me i ndihmu rastet, mirëpo është vërejtja ime rrëth procedurave, sepse nuk shkojnë përmes komisionit. Ne jemi organi më i lartë i Komunës, e ju po na qitni të pa pregetitur, sepse komisioni duhet me shiku lëndën dhe me na sjellë një arsyeshmëri të mirë. Po ashtu e keni edhe një Udhëzim Administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë, e cila e ndalon çdo subjekt në mënyrë retroaktive palës, mandej pagu diçka nëse e ndihmoni, ju jeni duke e shkelur ligjin ky ka kërkuar me i pagu këto faktura siç po e shoh unë, duhet me ja qit spitalit paratë, jo palës në xhirologarinë e vetë. Sepse ne po i'a lëshojm palëve paratë publike, kemi palë këtu që me ato para që i janë ndarë blenë makinë 12,000.00€.

**Nënkyetari i Komunës:** Ju e dini se kemi patur shumë raste dhe palët kanë kërkuar shumën prej 6,000.00€ dhe ne ju kemi ndarë shumën prej 9,000.00€, unë mendoj që këtë praktikë duhet ta ndalim, sepse nuk është në rregull dhe duhet ta dini që secila kërkësë që vjen këtu së pari shiqohet gjendja financiare e cila egziston. Gjendja financiare sa i përket këtij rasti nuk mund ta kalon shumën prej 5,000.00€. Secili është i obliguar që pasi ta përfundon operacionin dhe trajtimin shëndetësorë të vijë dhe të dëshmon atë me fatura përkatëse.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, sipas mundësive buxhetore për shërim shëndetësorë, për palën Avni Ademi’.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota ‘për’, asnjë ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm që votuan.

Dy anëtarë të Kuvendit të Komunës nuk morën pjesë në votim, sepse paraprakisht e deklaruan konfliktin e interesit.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare pnë shumë prej 5,000.00€ për shërimin shëndetësorë, për palën Avni Ademi’ dhe mori:

#### V E N D I M

Për aprovin e ‘Propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumën prej 5,000.00€ për shërimin shëndetësorë, për palën Avni Ademi’.

**Pika e gjashtë (6) - Propozim për rishqyrtimin e aktit sipas shkresës Nr. 0204-940/8, të datës 11.07.2019.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për rishqyrtim ‘Propozimin për rishqyrtimin e aktit sipas shkresës Nr. 0204-940/8, të datës 11.07.2019’, ku ndryshon vetëm pjesa hyrëse e vendimit për arsyen të një gabimi dhe lëshimi teknik, përmrbajtja mbetet e njëjtë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim ‘Propozimin për rishqyrtimin e aktit sipas shkresës Nr. 0204-940/8, të datës 11.07.2019’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovon ‘Propozimin për rishqyrtimin e aktit sipas shkresës Nr. 0204-940/8, të datës 11.07.2019’ dhe mori:

V E N D I M

Për rishqyrtimin e aktit sipas shkresës Nr. 0204-940/8, të datës 11.07.2019’.

**Pika e shtatë (7) - Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të ‘Kompleksit 300’ në Fushë-Kosovë, lidhur me ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim dhe analizim ‘Kërkesën e banorëve të ‘Kompleksit 300’ në Fushë-Kosovë, lidhur me ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare’, aty është ndërtuar edhe shkolla e re. Ftoi, përfaqësuesen e Ekzekutivit të Komunës që të na jap sqarime.

**Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban:** Në mungesë të pronave komunale është caktuar ky lokacion për vendosjen e ambulantës. Distanca ndërmjet objektit shëndetësore dhe objekteve të banimit sipas djellosjes dhe sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2017 kërkohet që të jetë në këndin prej 45 shkallë, mirëpo këtu lartësia e objektit duhet të jetë 8 + 1, këtu kemi të bëjmë me objektin përdhesë edhe një etazhë dhe lartësia maksimale është tetë metra, ndërsa distanca ndërmjet objektit shëndetësorë dhe objektit të banimit është gjashtë metra për dy metra është ndryshimi. Këto djellosje kërkohen për sallonet, ndërsa në këtë rast ne i kemi dhomat e fjetjes, sallonat dhe terracat janë në pjesën anësore të orientuara. Unë mendoj që nuk ka arsyen për mos lejimin e ndërtimit të kësaj ambulante, sepse nuk pengon ndriçimin dhe s'ka arsyetim. Parkingun këto banesa e kanë në pjesën tjeter. Interesi publik është më i rëndësishum se shfrytëzimi i parkingjeve të një grupi të caktuar të qytatarëve.

**Durim Hajra:** Sa i përket kësaj pike, unë mendoj se banorët kanë të drejtë të ankohen dhe të bëjnë peticione dhe të kundërshtojnë për atë që s’iu pëlqen. Ne nuk e mbështesim këtë vendim, duhet të gjendet ndonjë hapësirë tjeter. Në shkurt të këtij viti e kemi pas një plan në Kuvendin e Komunës dhe atëherë ne i kemi dhënë vërejtjet tona, sepse ndërtimi i shkollës e ngarkon atë kompleks, njësoi edhe Qendra e Mjekësisë Familjare, e ngarkon atë pjesë dhe banorët munden të reagojnë, ajo pjesë mund të jetë si park dhe si parking. Të gjithë e dimë se kemi mungesa të hapësirave publike.

**Mehdi Lahu:** Ju po thuani se është arritur marrëveshja, në kërkesë janë 45 nënshkrime, atëherë, personat e nëshkruar në kërkesë duhet t’i tërheqin nënshkrimet e tyre dhe të pajtohen për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare.

**Nënkyryetari i Komunës:** Ne kemi qenë të obliguar me sjell në Kuvendin e Komunës këtë pikë. Problem është se ne nuk po kemi hapësira ku t'i ndërtojmë këto objekte publike, sepse tokë nuk të jep askush këtu është e rëndësishme, se marrëveshja është arritur mes Ekzekutivit të Komunës dhe qytetarëve dhe palëve që janë në atë pjesë. Marrëveshja është arritur me kompenzim që do të ju bëhet atyre dy palëve, që kanë mungesë djellosje në banesat e tyre.

**Driton Ademi:** Ne nuk mund ta votojmë një marrëveshje që nuk e shohim fare, nuk e dijmë asnjë detajizim të saj.

Nënkyryetari I Komunës: fjala është për dy banues aty Gursel Arifi dhe Uran Limani, të cilët banojnë në katin përdhesë, do të kompensohen.

Pas sqarimeve, kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Marrëveshjen për kompensim të arritur nga Ekzekutivi i Komunës për banuesit z. Gursel Arifi dhe z. Uran Limani’ në funksion të realizimit të objektit publik Qendrës së Mjekësisë Familjare në ‘Kompleksin 300’ në Fushë-Kosovë.


U votua me: nëntë vota ‘për’ një ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej dhjetë anëtarë të pranishëm që votuan.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë kuorumi nuk e kalon ‘Marrëveshjen për kompensim të arritur nga Ekzekutivi i Komunës për banuesit z. Gursel Arifi dhe z. Uran Limani’ në funksion të realizimit të objektit publik Qendrës së Mjekësisë Familjare në ‘Kompleksin 300’ në Fushë-Kosovë.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesmarrje në mbledhje.  
Mbledhja përfundoi në orën 12:30 minuta.**

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

